



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 775/1 prot.

Shkoder, më 16.11.2020

LËNDA: Mbi vendimin nr. 63, datë 30.10.2020 të Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe.

KËSHILLIT BASHKIAK MALËSI E MADHE

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore", analizoi vendimin nr. 63, datë 30.10.2020 të Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe "Për miratim plani vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkia Malësi e Madhe 2021-2025".

Pas shqyrtimit, Prefekti konstaton se është në kompetencën e këshillit bashkiak sipas nenit 18, 54, gërma k, neni 55/2 e ligjit nr.139/2015 dhe ligjit nr.10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" -neni 12, të miratojë një vendim të tillë, me qëllim mbrojtjen e mjedisit. funksion vendor, referuar standardeve ligjore.

Administrimi i mbetjeve do të thotë grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi i mbetjeve. përfshirë dhe mbikëqyrjen e operacioneve të tilla si kujdesia më pas e venddepozitimeve të asgjësimit dhe veprimet e ndërmarra si tregtar apo ndërmjetës. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve e thekson në mënyrë të qartë faktin që asgjësimi është mënyra e fundit për t'u përdorur. dhe mund të përdoret vetëm në rastet kur mënyrat e tjera të hierarkisë nuk mund të jenë të zbatueshme. Asgjësimi është faza më pak e dëshirueshme e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve për arsye se nëpërmjet asgjësimit humbasin vlerat e materialeve. Aty ku rikuperimi i mbetjeve nuk ka ndodhur duhet që mbetjet t'u nënshtrohen operacioneve të sigurt të largimit dhe asgjësimit. Ky asgjësim mbetjesh duhet të bëhet pa dëmtuar shëndetin e njerëzve dhe atë të mjedisit. Asgjësimi është përkufizuar si një operacion që nuk është rikuperim edhe pse operacioni ka si një përfundim të dytë rikuperimin e substancave ose energjisë.

Mjedisi është jo vetëm pasuri e shumëllojshme ekosistemesh, por edhe një burim ekonomie që duhet përdorur me kujdes e strategjikisht dhe secili nga ne duhet të jetë i vetëdijshëm për detyrimin institucional, social dhe moral që të mirëmenaxhojmë dhe mbrojmë këtë pasuri në interes të qytetarëve dhe të brezave që vijnë.

Rekomandohet që të merren masa për diferencimin e mbetjeve që në burim. të forcohet mekanizmi për mbledhjen e tarifave vendore nga të gjithë banorët sipas parimit të barazisë. proporcionalitetit, transparencës si dhe parimit ndotësi paguan, duke zbatuar të gjitha aktet nënligjore të miratuara në fushën mjedisore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI